BULETIN INFORMATIV NR. I QERSHOR-GUSHT 2018

SPAK monitor

PËRMBAJTJA

- *Krijimi i SPAK jo vetëm si nevojë për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, por edhe për të siguruar integritetin e vetë reformës në drejtësi*
- *Përmbyllja e fazës së parë të procesit të rivlerësimit : Cila ka qenë ecuria e deritanishme e zhvillimit të seancave dëgjimore dhe vendimeve të KPK-së*
- *Efektet e procesit të rivlerësimit në ngritjen e organeve të reja të drejtësisë: Përsëritje e procedurave dhe shtyrje e afateve kohore*
- *Kriteret e zbatuara në rivlerësimin e subjekteve: Vlerësimi i pasurisë kriteri më problematik për shkarkimin e subjekteve nga detyra*
- *Procesi i rivlerësimit ndikim në mosfunksionimin e Gjykatës Kushtetuese, Kolegjeve të Gjykatës së Lartë dhe organeve të reja të krijuara (KED-së)*
- *Procesi i vetting-ut për punonjësit e Gjykatave të posaçme dhe SPAK: Cilat mund të jenë vonesat e mundshme*

***SPAK Monitor** vjen si një përpjekje e shoqërisë civile për të monitoruar, vlerësuar dhe informuar mbi krijimin e Gjykatave të posaçme dhe SPAK, si dhe për të sjellë këndvështrime dhe propozime që ndihmojnë në ecjen përpara të këtij procesi.*

Ky numër i parë i SPAK Monitor i dedikohet vlerësimit të zbatimit të procesit të vetting-ut, pasojave dhe ndikimit të tij për riorganizimin e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe synon të projektojë mundësinë e shmangies së vonesave që mund të shfaqen në procesin e vetingut të punonjësve të Gjykatave të posaçme dhe SPAK duke marrë shkas nga eksperienca me vetting-un e gjyqtarëve dhe prokurorëve në proces.

Procesi i vetting-ut për punonjësit e Gjykatave të posaçme dhe SPAK: Cilat mund të jenë vonesat e mundshme

Krijimi i SPAK jo vetëm si nevojë për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, por edhe për të siguruar integritetin e vetë reformës në drejtësi

Në mbi dy dekadat e tranzicionit korrupsioni dhe krimi i organizuar u shfaqën dhe mbeten ndër pengesat kryesore për zhvillimin mëtejshëm ekonomiko shoqëror dhe demokracisë në Shqipëri.

Të vetëdijshëm për këto pengesa dhe të nxitur nga faktori ndërkombëtar, kryesisht Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por dhe një presion gjithnjë në rritje i vetë shoqërisë shqiptare, institucionet politike shqiptare ndërmorën reformë në sistemin e drejtësisë.

Reforma përbëhet nga tri kolona kryesore: (1) **vetting-u**, i cili nëpërmjet rivlerësimit të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve që shërbejnë aktualisht në sistemin e drejtësisë synon largimin e të korruptuarve dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi; (2) **riorganizimi i organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë**, i cili synon përmirësimin e qeverisjes së këtij sistemi për ta bërë atë më të pavarur, të përgjegjshëm, efiçent dhe transparent; (3) **krijimi i institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar**, ku përfshihen Gjykatat kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit, të njohura ndryshe si **SPAK.**

Ndërtimi i këtyre kolonave është parashikuar si një proces i ndërlidhur, i cili **fillon me vetting-un**, vijon me riorganizimin e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, ku më kryesoret në radhën e proceseve janë **Këshilli i Lartë Gjyqësor** dhe **Këshilli i Lartë i Prokurorisë**, pasi krijimi i tyre do të hapë rrugën e fillimit të procesit të ngritjes së Gjykatave kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe SPAK.

Nga ana tjetër ka një ndërlidhje funksionale ndërmjet këtyre proceseve pasi edhe pse të fundit në zinxhirin e proceseve Gjykatat e posaçme dhe SPAK janë jetike për qëndrueshmërinë e tyre, pasi në një mjedis me korrupsion dhe ndikim të lartë të krimit të organizuar ekziston rreziku që vetë organet e reja të sistemit të drejtësisë të cënohen nga korrupsioni.

Për shkak të një sërë faktorësh, por kryesisht mosmarrveshjeve politike, numrit të lartë të gjyqtarëve dhe prokurorëve që kanë dështuar të kalojnë me sukses procesin e vetting-ut dhe densitetit të lartë të veprimtarive të parashikuara nga këto ligje, procesi i riorganizimit të organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë është vonuar dhe për pasojë kjo ka sjellë vonesë edhe në krijimin e Gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe SPAK.

Krijimi i Gjykatave kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe SPAK është mjaft i rëndësishëm për integritetin e proceseve të nisura, pasi korrupsioni dhe krimi i organizuar përbëjnë një kërcënim serioz për institucionet e reja. Përveç korrupsionit dhe krimit të organizuar Kushtetuta e ndryshuar dhe ligji për SPAK parashikojnë hetimin dhe gjykimin e veprave penale të kryera nga persona, të cilët mund të kenë pushtetin apo ndikimin për të ndalur një hetim.

Ligji për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar i miratuar në tetor të vitit 2016 parashikonte që Gjykatat e posaçme dhe SPAK të ishin ngritur dhe merrnin në zotërim kompetencat e parashikuara për to 300 ditë pas hyrjes në fuqi të ligjit, që përkon afërsisht me mesin e shtatorit të vitit 2017. Ky afat është tejkaluar me një vit dhe për shkak të ecurisë së proceseve të tjera që e kushtëzojnë krijimin e tyre, ka pak gjasa që të realizohet edhe deri në shtatorin e vitit 2019.

Krijimi i Gjykatave të posaçme dhe SPAK janë të pakthyeshme dhe do të vijojnë pavarësisht vonesave. Megjithatë krijimi i shpejtë i tyre nuk është i domosdoshëm vetëm për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, por dhe për të kontribuar në garantimin e integritetit të proceseve të tjera të reformës në drejtësi dhe mos kapjen e tyre nga korrupsioni që në hapat e para.

CSDG Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes

Përmbyllja e fazës së parë të procesit të rivlerësimit: Cila ka qenë ecuria e deritanishme e zhvillimit të seancave dëgjimore dhe vendimeve të KPK-së

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) zhvilloi seancën e parë dëgjimore në 21 mars 2018 duke vijuar procesin për afërsisht 5 muaj deri në datën 3 gusht 2018, datë në të cilën është zhvilluar edhe seanca e fundit për këtë sezon deri në fillimin e punës së Komisionit në shtator 2018. Gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të seancave dëgjimore, Komisioni ka njoftuar sistematikisht dhe në kohë në faqen zytare në lidhje me kalendarin për çdo seancë të zhvilluar, duke përfshirë edhe të dhënat për trupin gjykues. Në të njëjtën kohë i rëndësishëm mbetet fakti që të gjitha seancat dëgjimore kanë qenë transparente dhe janë ndjekur nga gazetarët, rregullat dhe informacioni për të cilët është rregulluar nga vetë Komisioni nëpërmjet koordinatorit për mediat. Ritmi i numrit të seancave dëgjimore është rritur veçanërisht në muajt Qershor dhe Korrik, periudhë në të cilën janë zhvilluar 38 seanca dëgjimore. Për shkak të vonesave në fillimin e aktivitetit të Komisionit dhe nevojës



për avancimin e procesit, kërkesa për përshpejtimin e ritmeve të punës dhe vlerësimin e subjekteve ka shoqëruar gjatë gjithë kohës punën e Komisionit.

Gjatë kësaj periudhe kohore Komisioni ka përfunduar rivlerësimin dhe ka dhënë vendimin për 51 subjekte apo rreth 85% pjesë e listës së përparësisë, përfshirë subjektet e dorëhequra. Deri në muajin gusht numri i ankimimeve me juridiksion rivlerësimi pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (KPA) ka qenë 12 dhe vetëm për 4 prej tyre ka përfunduar shqyrtimi. 8 nga 13 ankimime janë vënë në lëvizje nga Komisioneri Publik dhe ONM dhe 5 nga vetë subjektet e rivlerësuara. Pjesa më e madhe e ankimimeve (5 prej tyre) që Komisioneri Publik i ka drejtuar Kolegjit të Apelimit i referohen vendimit të konfirmimit në detyrë për subjektet e rivlerësimit.

Në muajin Shtator pritet të përmbyllet procesi i rivlerësimit për 6 subjektet e mbetura të kësaj liste, në mënyrë që ti hapet rrugë krijimit të organeve të reja të sistemit të drejtësisë. Siç mund të evidentohet edhe më poshtë, numri i subjekteve të shkarkuara përbën një diferencë prej vetëm 8 të tilla më pak se numri i subjekteve të konfirmuara. Pavarësisht se në muajin Shtator do të vijojë puna për vlerësimin e 6 subjekteve të mbetura nga lista e përparësisë, shkarkimi i një pjese të konsiderueshme të gjyqtarëve dhe prokurorëve ekzistues do të përbëjë shqetësim sa i përket ngritjes së organeve të reja në sistemin e drejtësisë.



Efektet e procesit të rivlerësimit në ngritjen e organeve të reja të drejtësisë: Përsëritje e procedurave dhe shtyrje e afateve kohore

Procesi i rivlerësimit të kandidatëve është kryer bazuar në vlerësimin e tre kritere të parashikuara në Ligjin 84/2016: 1) vlerësimin e pasurisë; 2) kontrollin e figurës dhe 3) vlerësimin e aftësive profesionale. Në funksion të detyrimeve ligjore për ngritjen e organeve të reja të drejtësisë, Komisioni nëpërmjet shortit të muajit dhjetor 2017 hartoi listën me 57 subjektet e përparësisë, kandidatë për anëtarë në KED; KLGJ; KLP dhe ILD. Këto subjekte iu nënshtruan të parat procedurave dhe procesit të rivlerësimit, por ende nuk mund të flitet për rezultate përfundimtare të të gjitha subjekteve prioritare, pasi ende 10 subjekte kandidatë janë në proces. Deri tani vetëm subjektet kandidatë për organin e KLGJ-së kanë përfunduar rivlerësimin, ndërkohë janë në proces 4 subjekte kandidatë për KLP; 5 për KED (organ i krijuar-anëtarët zgjedhur me short më 7 dhjetor 2017) dhe 1 për ILD.

Përveç faktorit kohor të nevojshëm për përfundimin e rivlerësimit të subjekteve të lartpërmendura, i rëndësishëm për tu theksuar mbetet fakti që edhe me përfundimin e procesit të rivlerësimit për të gjitha subjektet prioritare jo domosdoshmërisht arrihet të krijohen organet e reja të sistemit të drejtësisë. Një shembull i tillë është rasti i përfundimit të procesit për kandidatët anëtarë të KLGJ-së, ku vërehet që edhe subjektet e konfirmuara tashmë në detyrë nga Komisioni nuk plotësojnë ende kushtet ligjore, të cilat do të sillnin për rrjedhojë vijimin e procedurave për krijimin e institucionit. Në këtë mënyrë duket se procesi do të marrë ende kohë për të arritur në përfundimin e plotë të zgjedhjes së anëtarëve kandidatë, pjesë e organeve të reja të drejtësisë, të cilat do të jenë mjaft të rëndësishme në përzgjedhjen e anëtarëve të një tjetër strukture kyçe në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar siç është SPAK.

Rezultatet e procesit të rivlerësimit të subjekteve më lart, kanë krijuar nevojën për marrjen e masave respektive ligjore në lidhje me rifillimin e procedurave në rastet kur zgjedhja e anëtarëve kandidatë për krijimin e institucioneve të reja të drejtësisë nuk është arritur edhe pas përfundimit të procesit. Përsëritja e shpalljeve dhe respektimi i afateve dhe procedurave do të sjellë vonesa në kohë në krijimin e organeve të reja. Në datën 31.07.2018 Gjykata e Lartë ripublikoi thirrjen për shprehje interesi për gjyqtarët e gjykatave të apelit jashtë Tiranës për të paraqitur kandidaturën për tu zgjedhur në pozicionin e anëtarit të KLGJ-së, pozicion ky i paplotësuar edhe pas përfundimit të rivlerësimit të kandidatëve aplikantë në listën prioritare. Megjithatë edhe pas përfundimit të afatit të parashikuar në këtë thirrje, nuk u arrit rregjistrimi i asnjë kandidati, duke sjellë rishpalljen e thirrjes nga Gjykata e Lartë në datën 22.08.2018. proces i cili mori edhe vëmendjen e Ambasadës së SHBA, e cila i bëri thirrje publike gjyqtarëve të aplikojnë për anëtarë në KLGJ. Në këtë mënyrë, të gjitha pengesat evidentuar më lart, qoftë në institucionet ekzistuese, por edhe ato që pritet të krijohen, do të krijojnë një shtyrje të afateve kohore dhe përfundimit të procedurave ligjore.



Kriteret e zbatuara në rivlerësimin e subjekteve: Vlerësimi i pasurisë kriteri më problematik për shkarkimin e subjekteve nga detyra

Një nga çështjet më të rëndësishme trajtuar në vazhdimësi gjatë gjithë procesit të rivlerësimit lidhet me shqyrtimin e tre kritereve për konfirmimin ose jo në detyrë të subjekteve:

1. vlerësimin e pasurisë;
2. kontrollin e figurës dhe
3. vlerësimin e aftësive profesionale.

Komisioni i Kualifikimit është ndihmuar në këtë proces nga Njësia Ligjore e Komisionit, e cila përbëhet nga 16 këshilltarë, 12 prej të cilëve këshilltarë ligjorë dhe 4 këshilltarë ekonomikë. Ligji 84/2016 specifikon që: "*vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tre kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave*".

Megjithatë, përveç vlerësimit të aftësive profesionale me të cilat subjekti mund të konfirmohet edhe me një nivel minimal kualifikues, për vlerësimin e pasurisë dhe kontrollin e figurës arritja e një niveli të besueshëm vlerësimi është e detyrueshme. Në të njëjtën kohë Komisioni përveç konfirmimit apo shkarkimit nga detyra mund të vendosë për subjektin edhe pezullim nga detyra për një periudhë 1-vjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës.

Referuar vendimeve të bëra publike deri në këtë periudhë në faqen zyrtare të Komisionit, nga subjektet e konfirmuara në detyrë katër janë vlerësuar me një ***nivel minimal kualifikues*** në vlerësimin e aftësive profesionale dhe dy prej tyre janë vlerësuar me një ***nivel të pranueshëm*** të vlerësimit të aftësive profesionale.

Ndërkohë sa i përket arsyeve për moskonfirmimin në detyrë të subjekteve të shkarkuara, rezulton se kriteri kryesor për mos konfirmimin e tyre ka qenë vlerësimi i pasurisë. Gjatë seancave të fundit dëgjimore janë konfirmuar raste në të cilat subjektet kanë rezultuar problematikë lidhur me vlerësimin e figurës. Megjithatë këto raste kanë qenë më të pakta krahasuar me problematikat e evidentuara në vlerësimin e pasurisë. Deri tani asnjë nga subjektet për të cilat ka përfunduar rivlerësimi nuk ka marrë masën e pezullimit nga detyra. Komisioni pritet të përfundojë publikimin e arsyetuar të të gjitha vendimeve në periudhën në vijim, duke krijuar mundësinë për tu njohur në mënyrë më të saktë me kriteret mbi të cilat është bërë shkarkimi i të gjitha subjekteve të rivlerësuara deri në muajin gusht.



Procesi i rivlerësimit ndikim në mosfunksionimin e Gjykatës Kushtetuese, Kolegjeve të Gjykatës së Lartë dhe organeve të reja të krijuara (KED-së)

Procesi i rivlerësimit të subjekteve përveç mos ngritjes së organeve të reja të drejtësisë për shkak të vonesave dhe mosplotësimit të numrit të kandidatëve dhe kritereve ligjore, ka sjellë edhe mosfunksionimin e disa prej organeve ekzistuese më të rëndësishme të sistemit gjyqësor në vend siç janë dy gjykatat kryesore, Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë. Të konsideruar si subjekte prioritare për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit, më shumë se gjysma e anëtarëve të këtyre institucioneve nuk kanë marrë nga Komisioni konfirmimin në detyrë. Në këtë mënyrë 3 nga 5 anëtarë janë shkarkuar nga Gjykata Kushtetuese (3 anëtarëve u ka përfunduar mandati dhe 1 është do-rëhequr) dhe 5 nga 9 anëtarë të Gjykatës së Latë nuk janë konfirmuar gjithashtu. Gjykata Kushtetuese është tashmë jashtë funksionit në pamundësi për të shqyrtuar asnjë çështje apo për të pranuar ankesa nga qytetarët apo institucionet. Pavarësisht se në datën 28.08.2018 Kuvendi i Shqipërisë publikoi listën e kandidatëve për njërin nga shtatë vendet e mbetura bosh në Gjykatën Kushtetuese, specifikisht atë të Fatos Lulos të shkarkuar gjatë procesit të rivlerësimit, renditja fillestare e listës së aplikantëve duhet të realizohet nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, institucion i cili siç evidentohet edhe më poshtë është jo funksional. Ndërkohë që edhe tre kolegjet (Penal, Administrativ dhe Civil) e Gjykatës së Lartë tashmë nuk funksionojnë dhe shqyrtimi i dosjeve më urgjente realizohet vetëm në dhoma këshillimi. Gjendja paraqet një situatë problematike duke patur parasysh rolin mjaft të rëndësishëm të tyre, për më tepër që asnjë zgjidhje nuk është ofruar ende për daljen nga ngërçi i krijuar, duke sjellë në këtë mënyrë një boshllëk ligjor krejt të rrallë në vend.



Akoma më shqetësues mbetet fakti që edhe i vetmi nga organet e reja të krijuara rishtazi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED) është ballafaquar me një situatë të ngjashme. Edhe në këtë rast mos konfirmimi në detyrë i anëtarëve të institucionit ka sjellë mosfunksionimin total të tij. KED është institucioni i parë që u krijua në kuadër të reformës në drejtësi (Dhjetor 2017) dhe roli i tij është mjaft i rëndësishëm për kompetencën që ka ky Këshill në vlerësimin e kandidatëve për në Gjykatën Kushtetuese. Siç mund të vërehet më poshtë, 46% e anëtarëve tashmë të konfirmuar të Këshillit janë shkarkuar nga Komisioni i Kualifikimit dhe vetëm 18% e tyre janë konfirmuar. Anëtarët e KED-së, të cilët janë ende në proces rivlerësimi, pra 36% e tyre i përkasin anëtarëve zëvendësues të Këshillit.



Procesi i vetting-ut për punonjësit e Gjykatave të posaçme dhe SPAK: Cilat mund të jenë vonesat e mundshme

Procesi i vlerësimit parashikohet të kryhet edhe në kuadër të parashikimeve ligjore tranzitore për një nga institucionet më të rëndësishme që pritet të krijohet siç është Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK). Në Ligjin 95/2016, Nenin 6 jepen specifikimet në lidhje me kryerjen e këtij vlerësimi dhe procedurat e verifikimit të kushteve të sigurisë, të cilat referuar periudhës tranzitore do të realizohen nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK). Duke qenë se tashmë Komisioni i Kualifikimit ka realizuar për një periudhë afërsisht 5 mujore procedurat e rivlerësimit për 51 subjekte, kjo përvojë mund të shërbejë për të sjellë në vëmendje disa efekte të krijuara nga ky proces, të cilat do të mund të gjejnë zbatim edhe në kuadër të verifikimit të kushteve të sigurisë për strukturën e SPAK.

Ligji për SPAK 95/2016 e shtrin **kontrollin e pasurisë dhe figurës edhe për nëpunësit dhe personelin.** Për këto subjekte parashikohet gjithashtu një proces vlerësimi për një periudhë 2- vjeçare nga hyrja në fuqi e tij dhe më specifikisht për:

a) kandidatët për nëpunës civilë gjyqësorë në gjykatat e posaçme,

b) personel administrativ në Prokurorinë e Posaçme,

c) Drejtor dhe për hetues të Byrosë Kombëtare të Hetimit,

d) si dhe familjarët e afërm të tyre.

Në këtë rast procesi i vlerësimit do të realizohet jo më nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, por nga një Komision i Posaçëm i përbërë nga:

a) dy prokurorë të Prokurorisë së Posaçme, të zgjedhur me short, proces i cili monitorohet nga Avokati i Popullit;

b) një gjyqtar të gjykatave të posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, i zgjedhur me short, process i monitoruar nga Avokati i Popullit.

Për shkak të procesit së ngritjes së këtyre strukturave në kohë, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit do të jetë përsëri institucioni përgjegjës për kryerjen e këtij procesi, duke përfshirë në këtë mënyrë edhe vlerësimin e kontrollit të pasurisë dhe figurës për familjarët e afërt. Këto të fundit nënkuptojnë bashkëshortin/bashkëshorten, fëmijët mbi 18 vjeç dhe çdo person të lidhur nga gjaku apo martesa, i cili banon më shumë se 120 ditë në vit në të njëjtin vendbanim. Ligji për SPAK parashikon krijimin e një Komisioni të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve, por në këtë fazë tranzitore ky vlerësim do të realizohet nga KPK, përfshirë këtu vlerësimin për familjarët e afërm.

Përmbushje të kushtit të sigurisë (KPK)

- Kandidatët për gjyqtarë në Gjykatat e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar;
- Kandidatët për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme;
- Familjarë të afërm të tyre

Përmbushje të kushtit të sigurisë (Komisioni i Posaçëm)

- Kandidatët për nëpunës civilë gjyqësorë në gjykatat e posaçme;
- Personel administrativ në Prokurorinë e Posaçme;
- Drejtor dhe hetues të Byrosë Kombëtare të Hetimit;
- Familjarët e afërm të tyre

Megjithatë dhe pavarësisht rregullimit ligjor në lidhje me realizimin e procesit të vlerësimit për punonjësit e Gjykatave të posaçme dhe SPAK, nisur nga praktika e deritanishme e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve identifikimi i disa çështjeve prezente do të mund të shërbente në përmirësimin e vetë procesit.

- *Mungesa e specifikimit të afateve kohore;*

Ligji nuk arrin të parashikojë në lidhje me periudhën e nevojshme për realizimin e pocesit të vlerësimit dhe plotësimit të kushteve të sigurisë për subjektet që i nënshtrohen këtij procesi. Ashtu si edhe në përvojën e deritanishme të procesit të rivlerësimit për gjyqtarët dhe prokurorët, vonesat e shkaktuara krijuan një bllokim dhe vakum ligjor me mjaft pasoja jo vetëm në funksionimin e stukturave ekzistuese, por edhe në ngritjen dhe funksionimin e organeve të reja. Vonesat konsistuan jo vetëm në zgjatje të afateve kohore të nevojshme për vlerësimin e subjekteve, por në të njëjtën kohë edhe në vonesa të lidhura me mosplotësim të kushteve parashikuar në ligj. Kjo solli ripërsëritje të procedurave dhe si rrjedhojë shtyrje të njëpasnjëshme të afateve. Në këto kushte edhe në ligjin për SPAK është e paqartë se si vonesa të mundshme gjatë vlerësimit të kushteve të sigurisë do të mund të ndikojnë në fillimin e punës së vetë institucionit. Në këtë drejtim është themelore të përcaktohen rregulla të detajuara jo vetëm të shtrirjes kohore të procesit, por edhe të specifikimeve që lidhen me numrin e nevojshmë të punonjësve që mundet ose jo të kalojnë vlerësimin për plotësimin e kushteve të sigurisë.

- *Kriteret e vlerësimit për plotësimin e kushteve të sigurisë dhe asistenca e ekspertëve;*

Vlerësimi i kushteve të sigurisë bazuar në kriteret e pasurisë dhe figurës, kërkon përfshirjen e institucioneve specifike, por edhe ekspertëve të fushës. Në rastin e KPK-së procesi është ndihmuar nga Njësia Ligjore e përbërë me këshilltarë ligjorë dhe ekonomikë. Ndërkohë referuar periudhës tranzitore të ligjit për SPAK, në rastin e vlerësimit të këtyre kritereve nga Komisioni i Posaçëm, i përbërë nga prokurorë dhe gjyqtarë ky proces nuk parashikohet të asistohet nga ekspertë të fushës apo anëtarë të tjerë në komision, përgjegjës për specifikat në vlerësimin e këtyre dy kritereve. Pavarësisht se Komisioni i Posaçëm merr nga institucionet e emërtesës deklaratat respektive të punonjësve apo subjekteve për vlerësim, ai duhet të realizojë verifikimet e nevojshme për pasurinë dhe figurën, çka shtron nevojën e një bashkëpunimi teknik dhe sa më të saktë.

- *Mundësia e ankimimit të vlerësimit dhe transparenca e procesit;*

Në rastin e çështjeve të trajtuara nga Komisioni i Kualifikimit, Kolegji i Posaçëm i Apelimit (KPA) është struktura përgjegjëse për ankimimin ndaj vendimeve të Komisionit, duke patur në këtë mënyrë një rol po kaq kryesor në proces. Në rastin e vlerësimit që do të realizohet në kuadër të SPAK mbetet e paqartë pjesa e ankimit të vlerësimeve që parashikohet të kryhen nga Komisioni i Posaçëm. Nëse do të ketë mos dakordësi në vlerësimin e dhënë për plotësimin e kushteve të sigurisë për punonjësit e këtyre struktura, nuk është e qartë mënyra e ankimit apo strukturat përgjegjëse.

Në të njëjtën kohë edhe procesi i transparencës përbën një rëndësi të veçantë gjatë vlerësimit të subjekteve. Ndjekja nga afër e seancave dëgjimore gjatë rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe publikimi jo vetëm i vendimeve, por edhe ritmeve të punës së Komisionit, tregoi se procesi është mjaft dinamik, me shumë zhvillime dhe me shumë informacione të rëndësishme. Ky standard do të duhet të zbatohet me po të njëjtën rëndësi edhe në rastin e vlerësimeve nga Komisioni i Posaçëm i vlerësimit.

KY BULETIN REALIZOHET NË KUADËR TË PROJEKTIT: FORCIMI I INFORMIMIT DHE PJESMARRJES SË PUBLIKUT NË ZBATIMIN E REFORMËS NË DREJTËSI NËPËRMJET MONITORIMIT, VLERËSIMIT DHE KOMUNIKIMIT TË PROCESIT TË NGRITJES DHE FUNKSIONIMIT TË INSTITUCIONEVE PËR TË LUFTUAR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

Projekt i financuar nga:

Fondacioni

Shoqëria e Hapur për Shqipërinë

Gjatë periudhës Korrik 2018 – Korrik 2019 Qëndra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG Albania) do të punojë për zbatimin e projektit të financuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë " Forcimi i informimit dhe pjesmarrjes së publikut në zbatimin e reformës në drejtësi nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe komunikimit të procesit të ngritjes dhe funksionimit të institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar".

Reforma në sistemin e drejtësisë është një nga reformat më të thella dhe gjithëpërfshirësë të ndërmarra në Shqipëri në vitet e fundit, e cila synon të adresojë problemin e hetimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar, të evidentuara ndër pengesat kryesore për zhvillimin e metejshëm ekonomiko shoqëror të vendit dhe për antarësimin në Bashkimin Europian. Një nga komponentët kryesorë të kësaj reforme është ngritja e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI PROJEKTIN

OPEN SOCIETY FOUNDATIONS

Kohëzgjatja	Qershor 2018 – Korrik 2019
Programi/ Fusha e zbatimit	Programi i Reformës në Drejtësi financuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë
Nevoja e zbatimit të këtij Projekti	Vonesat e shkaktuara në ngritjen e institucioneve të vetting-ut dhe vështirësia për të ndjekur dhe kuptuar aspektet teknike të procesit.
Qëllimi i Projektit	Qëllimi kryesor i projektit është rritja e cilësisë së informimit mbi reformën në drejtësi dhe mbështetjes së kuptueshmërisë së qytetarëve dhe aktorëve shoqërorë përsa i përket zbatimit të reformës.
Objektivat e Projektit	Objektivat specifikë të projektit janë: · Të monitorojë dhe vlerësojë procesin e ngritjes dhe funksionimit të institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar; · Të inkurajojë dhe nxisë diskutimin dhe pjesmarrjen e mirëinformuar të qytetarëve dhe aktorëve shoqërorë në procesin e krijimit dhe funksionimit të institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar; · Të advokojë dhe mbështesë autoritetet shtetërore përgjegjëse për zbatimin e reformës në drejtësi.
Instrumentat dhe mekanizmat	Forcimi i informimit dhe pjesmarrjes së publikut në zbatimin e reformës në drejtësi nëpërmjet **(1) monitorimit, (2) vlerësimit dhe (3) komunikimit** të procesit të ngritjes dhe funksionimit të institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.
Institucionet e reformës në drejtësi, fokus i Projektit	· Gjykata e Shkallës së Parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar · Gjykata e Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar · SPAK një strukturë e cila përbëhet nga dy komponentë: · Prokuroria e Posaçme · Byroja Kombëtare e Hetimit
Produktet e Projektit	· Gjenerimi i dy raporteve hulumtuese · Përgatitja e katër buletineve informuese, një në çdo tre muaj, nën titullin "SPAK Monitor" · Një Raport përfundimtar I projektit · Publikimi i dymbëdhjetë artikujve në media të bazuar në gjetje nga hulumtimi · Përgatitja dhe shpërndarja e dy spoteve audiovizuale sensibilizuese e informuese · Dy tryeza të rrumbullakta me pjesmarrjen e palëvë të interesuara · Një konferencë përfundimtare
Rezultatet e pritshme	Rezultatet e pritshme të projektit janë: · Përmirësimi i informimit dhe pjesmarrjes së publikut në proces; · Përmirësimi i ecurisë dhe cilësisë së procesit të ngritjes dhe funksionimit të institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar; Përmirësimi i mekanizmave të kontrollit, mbikqyrjes dhe llogaridhënies dhe në tërësi një ecuri më e mirë e procesit të zbatimit të reformës në drejtësi.
Përfituesit kryesorë	Përfituesit kryesorë të projektit do të jenë: · Publiku i gjerë, i cili do të ketë një shkallë më të lartë informimi dhe pjesmarrje dhe për pasojë ndikim mbi procesin; · Organizatat e mediave dhe gazetarë, të cilat do të rrisin cilësinë dhe shpeshtësinë e informimit mbi krijimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar dhe funksionimin në periudhën e hershme të tyre; · Organizatat e shoqërisë civile, të cilat do të forcojnë rolin dhe ndikimin e tyre monitorues dhe mbikëqyrës, · Institucionet politikëbërëse dhe ligjzbatuese, të cilat do të kenë legjitimitet të shtuar si rezultat i ndërveprimit më të hapur me publikun dhe aktorët shoqërorë në tërësi.